

Konsultim paraprak | Tiranë, më 31.07.2026

STRATEGJIA SEKTORIALE E TRANSPORTIT 2030, DHE PLANI I VEPRIMIT

Vleresimi Strategjik Mjedisor (VSM-s)

Metodologjia dhe Fusha e Studimit te VSM

Përmbajtja dhe qëllimi i prezantimit

Konsultim paraprak për metodologjinë dhe fushën e studimit të VSM-së

Përmbajtja e prezantimit


- Hapat kryesorë të zhvillimit të VSM-së sipas Inception Report
- Përmbledhje e shkurtër e Strategjisë Sektoriale të Transportit 2030
- Kuadri ligjor dhe metodologjia e VSM-së
- Matrica e lidhjes ndërmjet Strategjisë, masave dhe objektivave të VSM-së
- Scoping Assessment, ndikimet paraprake dhe temat prioritare
- Gjendja ekzistuese, burimet e të dhënave dhe mangësitë kryesore
- Indikatorët e Strategjisë dhe përdorimi i tyre në VSM
- Diskutim dhe komentet e autoriteteve dhe grupeve të interesit

Qëllimi i prezantimit

1. Të përmbushet detyrimi ligjor për konsultimin e metodologjisë dhe fushës së studimit të VSM-së.
2. Të prezantohet ndërveprimi i Strategjisë së Transportit 2030 me objektivat e VSM-së.
3. Të paraqitet vlerësimi i fushës së studimit
4. Të sqarohen metodologjia, procesi dhe përdorimi i indikatorëve/te dhënave në VSM.
5. Të merren sugjerime për çështjet që duhet të përfshihen në studimin e VSM-së.

Hapat kryesorë të zhvillimit të VSM-së

Metodologjia ruan gjurmueshmërinë nga shqyrtimi i Strategjisë deri te rekomandimet, monitorimi dhe finalizimi.



Strategjia e Transportit 2030 – përmbledhje e shkurtër

Vizioni: Një sistem transporti i sigurt, i qëndrueshëm, inteligjent dhe i integruar me acquis të BE-së dhe rrjetin TEN-T (Rrjeti Trans-European i Transportit)

SP1

**Përafrimi dhe zbatimi i
acquis të BE-së**

SP2

**Lidhshmëria
rajonale dhe
TEN-T**

SP3

**Lëvizshmëria e
qëndrueshme dhe
rezistente ndaj
klimes**

SP4

**Siguria, mbrojtja dhe
të drejtat e
udhëtarëve**

15 objektiva zyrtare • 169 masa/nën-masa/projekte • zbatim deri në 2030, me elemente TEN-T deri në 2050.

15 objektivat e Strategjisë dhe struktura e Planit të Veprimit

SP1

- 1.1 Përafrimi i legjislacionit me acquis të BE-së
- 1.2 Zbatimi efektiv i acquis të BE-së

SP2

- 2.1 Lidhshmëria rajonale dhe TEN-T
- 2.2 RAMS dhe mirëmbajtja e bazuar në performancë
- 2.3 Përmirësimi i lidhshmërisë ndërkufitare

SP3

- 3.1 Dekarbonizimi dhe karburantet alternative
- 3.2 Sistemet Inteligjente të Transportit (ITS) dhe digjitalizimi
- 3.3 Multimodaliteti dhe zhvendosja modale
- 3.4 Qëndrueshmëria klimatike e infrastrukturës së transportit
- 3.5 Reforma e transportit rrugor ndërqytetës
- 3.6 Planet e Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme, SUMP

SP4

- 4.1 Menaxhimi multimodal i sigurisë
- 4.2 Zbatimi i rregullave të sigurisë dhe standardeve sociale
- 4.3 Të drejtat, cilësia e shërbimit dhe aksesueshmëria
- 4.4 Siguria në porte, aeroporte dhe nyje multimodale

Matrica ruan gjurmueshmërinë nga prioriteti → objektivi → masa/nënmasa → objektivi i VSM-së.

Kuadri ligjor dhe baza metodologjike e VSM-së

Baza ligjore

- Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i përditësuar
- VKM nr. 219, datë 11.03.2015, konsultimi me grupet e interesit dhe publikun
- VKM nr. 620, datë 07.07.2015, procedurat ndërkufitare të VSM-së
- Direktiva 2001/42/EC e BE-së për vlerësimin e planeve dhe programeve

Hapat metodologjikë

- Shqyrtimi i Strategjisë, bazës ligjore dhe politikave përkatëse
- Përcaktimi i fushës së studimit, ndërveprimi i Strategjisë me objektivat e VSM-së, receptorët dhe alternativat
- Analiza e gjendjes bazë mjedisore, klimatike dhe sociale
- Vlerësimi i ndikimeve, përfshirë efektet kumulative dhe ndërkufitare
- Masat zbutëse, përmirësuese dhe programi i monitorimit
- Konsultimi, integrimi i komenteve dhe finalizimi i Raportit të VSM-së

Gjendja bazë: të dhënat, burimet dhe mangësitë kryesore

Baza krahasuese për vlerësimin e ndikimeve, alternativave, masave dhe monitorimit

1. Fusha e analizës

- Gjendja aktuale dhe tendencat e mundshme, me dhe pa zbatimin e Strategjisë.
- Receptorët mjedisorë, klimatikë dhe socialë në nivel kombëtar, rajonal dhe përgjatë korridoreve të transportit.
- Ndjeshmëritë hapësinore, përfshirë zonat e mbrojtura, ujërat, vendbanimet, trashëgiminë kulturore dhe rreziqet natyrore.
- Disponueshmëria, cilësia dhe kufizimet e të dhënave që ndikojnë në shkallën e vlerësimit.

2. Të dhënat e disponueshme

- Strategjia dhe Plani i Veprimit, objektivat, masat, projektet, afatet, kostot dhe indikatorët.
- Rrjeti rrugor dhe hekurudhor, portet, aeroportet, terminalët, ITS, RAMS dhe rrjeti TEN-T.
- Indikatorët për automjetet elektrike, digjitalizimin, SUMP, sigurinë rrugore dhe zhvendosjen modale.
- Të dhëna të pjesshme për emetimet GHG, cilësinë e ajrit, klimën, aksidentet dhe flotën e automjeteve.

3. Burimet kryesore

- MIE, institucionet zbatuese sektoriale, Plani i Veprimit dhe sistemi TODIS.
- INSTAT, DPSHTRR, Policia e Shtetit, AKM dhe institucionet përgjegjëse për klimën dhe energjinë.
- ASIG, AKPT, AKZM, autoritetet e ujërave, mbrojtjes civile dhe bashkitë.
- Transport Community, Bashkimi Evropian, NECP, NDC, inventari kombëtar i GHG-ve, institucionet financiare ndërkombëtare dhe dokumentacioni i projekteve..

Mangësitë kryesore/nevojat për plotësim

- Inventari dhe skenarët e GHG-ve sipas mënyrës së transportit dhe llojit të karburantit.
- Të dhëna/studime të pamjaftueshme për cilësinë e ajrit, zhurmën dhe popullsinë e ekspozuar ndaj ndikimeve të transportit.
- Databaze jo të plota ose jo të disponueshme për projektet, receptorët e ndjeshëm, rreziqet klimatike dhe zonat e mbrojtura.
- Të dhënat për aksesueshmërinë, përballueshmërinë, cilësinë e shërbimit, ankesat dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar,

Përdorimi në VSM: Vlerësim sasior aty ku të dhënat janë të mjaftueshme; vlerësim gjysmë-sasior, GIS, ekspertizë dhe kërkesa monitorimi për temat me mungesa.

15 objektivat e VSM-së që do të analizohen kundrejt Strategjisë

Klima dhe ndotja

- 01 Zbutja e ndryshimeve klimatike
- 02 Qëndrueshmëria ndaj klimës
- 03 Cilësia e ajrit
- 04 Zhurma dhe vibrimet

Natyra dhe burimet

- 05 Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura
- 06 Ujërat dhe ekosistemet ujore
- 07 Toka, dherat dhe peizazhi
- 08 Efienca e burimeve dhe ekonomia qarkulluese
- 09 Trashëgimia kulturore

Shoqëria dhe mobiliteti

- 10 Shëndeti publik dhe siguria
- 11 Aksesueshmëria dhe përfshirja
- 12 Lëvizshmëria e qëndrueshme
- 13 Kohezioni territorial dhe ekonomia

Efekte të ndërthurura

- 14 Kumulative dhe ndërkufitare
- 15 Qeverisja dhe monitorimi

Këto objektiva do përdoren për të vlerësuar çdo objektiv dhe masë të Strategjisë, përmes kriterëve, indikatorëve dhe shqyrtimit të ndërveprimit/studimit (Scope In / Scope Out).

Si funksionon matrica e VSM-së

Prioriteti Strategjik (SP) → Objektivi i Strategjisë → Masa / nënmasa / projekt → Rezultatet e pritshme → Objektivi i VSM-së → Kriteret → Indikatorët → Vlerësimi paraprak → Scope In / Scope Out

Kodi / shkurtimi	Kuptimi
SP1–SP4	4 prioritetet strategjike të Strategjisë së Transportit 2030
1.1–4.4	15 objektivat zyrtare të Strategjisë
Axx.xx	Numri i masës / nënmasës sipas Planit të Veprimit
VSM-01–VSM-15	Objektivat e punës së VSM-së, të lidhura me receptorët, kriteret dhe indikatorët
++ / + / 0 / - / -- / ?	Shkalla paraprake e ndërveprimit dhe rëndësisë strategjike

Ndërveprimi Strategji-VSM

1

Politika dhe rregullimi

Standardet, acquis, tarifimi, të drejtat dhe mbikëqyrja

Efekte kryesisht indirekte mbi zbatimin dhe performancën

2

Investimet fizike

Rrugë, hekurudha, porte, aeroporte, terminale

Zënie toke, biodiversitet, ujë, zhurmë, peizazh, trashëgimi

3

Operacionet dhe shërbimet

Trafiku, transporti publik, logjistikë dhe mirëmbajtja

Emetimet, siguria, aksesueshmëria dhe vazhdimësia/cilesia e shërbimeve

4

Digjitalizimi dhe qeverisja

ITS, RAMS, biletimi, të dhëna dhe monitorim

Efikasiteti dhe kontrolli; efektet tërthore dhe shpërndarëse

Scoping kontrollon nëse këto rrugë ndikimi janë të rëndësishme për objektivat e VSM-së.

Matrica e përmbledhur e Scoping sipas objektivave të Strategjisë

Të gjitha 15 objektivat e Strategjisë, me objektivat kryesore të VSM-së

SP	Obj.	Objektivi i Strategjisë	GHG	Klimë	Ajër	Bio	Ujë	Tokë	Shëndet	Social	Mobil.	Kumul.	Qever.
SP1	1.1	Përafrimi me acquis të BE-së	+	+	+	0	0	0	++	+	++	+	++
SP1	1.2	Zbatimi i acquis të BE-së	+	+	+	0	+	0	++	+	++	+	++
SP2	2.1	Përfundimi i rrjetit TEN-T	?	?	?	--	-	--	?	++	?	--	+
SP2	2.2	RAMS dhe mirëmbajtja me performancë	+	++	+	+	+	++	++	+	+	+	++
SP2	2.3	Lidhshmëria ndërkufitare	?	+	+	?	?	-	+	+	+	++	+
SP3	3.1	Dekarbonizimi dhe karburantet alternative	++	+	++	?	?	-	++	+	++	+	+
SP3	3.2	ITS dhe digjitalizimi	+	+	+	0	0	0	++	++	++	+	++
SP3	3.3	Multimodaliteti dhe zhvendosja modale	++	+	++	?	?	-	+	+	++	+	+
SP3	3.4	Qëndrueshmëria klimatike	+	++	0	?	++	?	++	+	+	++	++
SP3	3.5	Transporti rrugor ndërqytetës	++	+	++	?	0	?	++	++	++	+	++
SP3	3.6	Planet SUMP, lëvizshmëria urbane	++	+	++	+	+	+	++	++	++	+	++
SP4	4.1	Menaxhimi multimodal i sigurisë	0	+	0	0	+	0	++	+	+	+	++
SP4	4.2	Zbatimi i rregullave të sigurisë dhe sociale	0	0	+	0	+	0	++	++	+	+	++
SP4	4.3	Të drejtat dhe aksesueshmëria e pasagjerëve	+	+	+	0	0	0	++	++	++	+	++
SP4	4.4	Siguria në porte, aeroporte dhe nyje	0	++	0	0	+	0	++	+	+	++	++

Legjenda: ++ ndikim i madh pozitiv, + pozitiv, 0 neutral, - negativ, -- negativ i madh, ? i pasigurt ose i varur nga vendndodhja/alternativa.

Lidhja e objektivave të Strategjisë me objektivat e VSM-së, 1/2

Kodi	Objektivi i Strategjisë	Fokusi/ndërveprimi kryesor me objektivat e VSM-së	Scope In
1.1	Përafrimi me acquis të BE-së	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Burimet, Shëndeti / siguria, etj.	11/15
1.2	Zbatimi i acquis të BE-së	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Ujërat, Burimet, etj.	12/15
2.1	Përfundimi i rrjetit TEN-T	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Biodiversiteti, Ujërat, etj.	15/15
2.2	RAMS dhe mirëmbajtja me performancë	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Biodiversiteti, Ujërat, etj.	15/15
2.3	Lidhshmëria ndërkufitare	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Biodiversiteti, Ujërat, etj.	15/15
3.1	Dekarbonizimi dhe karburantet alternative	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Biodiversiteti, Ujërat, etj.	15/15
3.2	ITS dhe digjitalizimi	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Burimet, Shëndeti / siguria, etj.	11/15
3.3	Multimodaliteti dhe zhvendosja modale	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Biodiversiteti, Ujërat, etj.	15/15

Lidhja e objektivave të Strategjisë me objektivat e VSM-së, 2/2

Kodi	Objektivi i Strategjisë	Fokusi kryesor i VSM-së	Scope In
3.4	Qëndrueshmëria klimatike	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Biodiversiteti, Ujërat, Toka / peizazhi, Burimet, etj.	13/15
3.5	Transporti rrugor ndërqytetës	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Biodiversiteti, Toka / peizazhi, etj.	13/15
3.6	Planet SUMP, lëvizshmëria urbane	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Biodiversiteti, Ujërat, etj.	15/15
4.1	Menaxhimi multimodal i sigorisë	Qëndrueshmëri klimatike, Ujërat, Shëndeti / siguria, Aksesueshmëria, Lëvizshmëria, Kohezioni, etj.	8/15
4.2	Zbatimi i rregullave të sigorisë dhe sociale	Ajri, Ujërat, Burimet, Shëndeti / siguria, Aksesueshmëria, Lëvizshmëria, etj.	9/15
4.3	Të drejtat dhe aksesueshmëria e pasagjerëve	Klima / GHG, Qëndrueshmëri klimatike, Ajri, Zhurma, Shëndeti / siguria, Aksesueshmëria, etj.	10/15
4.4	Siguria në porte, aeroporte dhe nyje	Qëndrueshmëri klimatike, Ujërat, Burimet, Shëndeti / siguria, Aksesueshmëria, Lëvizshmëria, etj.	9/15

Sqarim: SUMP = Plan i Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme. Objektivi 3.6 lidhet veçanërisht me cilësinë e ajrit, zhurmën, shëndetin publik, aksesueshmërinë, lëvizshmërinë dhe qeverisjen lokale.

Rezultatet kryesore të Scoping Assessment

15

Objektiva të Strategjisë

15

Objektiva të VSM-së

225

Ndërveprime të vlerësuara

186

Ndërveprime të
përzgjedhura (Scope-In)

39

Te përjashtuara si pa ndikim Scope
Out

- Shumica e ndërveprimeve u klasifikuan si Scope In, sepse Strategjia përfshin masa infrastrukturore, politike, operacionale dhe institucionale me ndikim të mundshëm në klimë, mjedis dhe aspektet sociale.
- Objektivat me prioritet të lartë për analizë të detajuar janë, TEN-T dhe lidhshmëria rajonale, dekarbonizimi, multimodaliteti, qëndrueshmëria klimatike, reforma e transportit ndërqytetës dhe planet SUMP, planet e lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme.
- Objektivat ligjore dhe institucionale, veçanërisht SP1 dhe SP4, japin kryesisht efekte indirekte, por të rëndësishme për qeverisjen, zbatimin, sigurinë dhe monitorimin.

Objektivat e Strategjisë me prioritet më të lartë për studim të mëtejshëm

Kodi	Objektivi i Strategjisë	Scope In	Pse është prioritar
2.1	Përfundimi i rrjetit TEN-T	15/15	Ndikime hapësinore, kumulative dhe ndërkufitare nga korridoret dhe nyjet TEN-T.
3.4	Qëndrueshmëria klimatike	13/15	Rreziqë klimatike, vazhdimësi shërbimi dhe mbrojtje e aseteve kritike.
3.5	Transporti rrugor ndërqytetës	13/15	Përfitime sociale, akses, siguri dhe reduktim i emetimeve nga transporti publik.
3.1	Dekarbonizimi dhe karburantet alternative	15/15	Dekarbonizimi, cilësia ajri, karburantet alternative dhe cikli i jetes se teknologjive.
3.6	Planet SUMP, lëvizshmëria urbane	15/15	Planet SUMP ndikojnë drejtpërdrejt në qytete, shëndet, ajër, zhurmë dhe akses.
3.3	Multimodaliteti dhe zhvendosja modale	15/15	Zhvendosje modale, logjistikë multimodale dhe përfitime klimatike.
2.3	Lidhshmëria ndërkufitare	15/15	Dimensioni ndërkufitar, efekte mbi korridoret dhe pikat kufitare.
2.2	RAMS dhe mirëmbajtja me performancë	15/15	RAMS, mirëmbajtje, siguri, jetëgjatësi e aseteve dhe monitorim.

Temat prioritare te shqyrtimit – analizohen me detaje ne VSM

1. Ndryshimet klimatike dhe energjia

Ulja e GHG, zhvendosja modale, karburantet alternative, efienca energjetike dhe rezistenca ndaj klimës.

2. Ndikimet hapësinore të investimeve TEN-T

Zënia e tokës, fragmentimi i habitateve, efektet mbi ujërat, peizazhin dhe trashëgiminë kulturore, etj

3. Cilësia e ajrit, zhurma dhe shëndeti publik

Ndikimet nga trafiku, portet, aeroportet dhe nyjet logjistike, si dhe përfitimet nga transporti publik dhe lëvizshmëria aktive.

4. Aksesueshmëria, përfshirja sociale dhe siguria

Përballueshmëria, aksesueshmëria për grupet e cënueshme, siguria rrugore, të drejtat e pasagjerëve dhe ndarja territoriale e përfitimeve.

5. Efektet kumulative dhe ndërkufitare

Ndërveprimi me planet e tjera, korridoret kufitare, basenet ujore të përbashkëta dhe rrjetet TEN-T.

Vlerësimi i mëtejshëm dhe indikatorët e matshëm të Strategjisë që ndihmojnë VSM-në

Indikatorë që mund të përdoren drejtpërdrejt ose si bazë për vlerësimin sasior të ndikimeve

Konkluzion kryesor: Strategjia ka një kornizë monitorimi me indikatorë sasiorë të zbatimit dhe performancës. Këta indikatorë janë të dobishëm për VSM, por nuk zëvendësojnë vlerësimin sasior të ndikimeve mjedisore, sociale dhe klimatike.

Objekti	Indikator i Strategjisë	Bazë / target 2030	Përdorimi në VSM
1.1	Përqindja e acquis të BE-së të transpozuar	Target 100% deri në 2027	Qeverisja, përputhshmëria ligjore dhe kushtet për performancë mjedisore
2.1	Pjesa e rrjetit TEN-T Core e përfunduar	Target 80%	Lidhshmëria, presioni hapësinor, alternativat dhe efektet kumulative
2.2	TEN-T i menaxhuar me RAMS dhe kontrata mirëmbajtjeje	0% → 100%; 4 kontrata	Qëndrueshmëria klimatike, siguria, mirëmbajtja dhe përdorimi eficient i aseteve
3.2	Mbulimi ITS; rrugët me e-tolling; biletimi digjital	25% → 100%; 0% → 20%; jo → po	Efienca e trafikut, ulja e bllokimeve, siguria dhe aksesueshmëria
3.6	Numri i Planeve të Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme, SUMP	1 → 5	Mobilitet urban, ajër, zhurmë, siguri rrugore, përfshirje sociale
4.1	Vdekje në rrugë për 100,000 banorë	7.3; target -50% krahasuar me 2021	Shëndeti publik dhe siguria rrugore, indikator i fortë sasior

Shënim: disa vlera të tabelës së Strategjisë kërkojnë konfirmim të formatit, njësive, burimit dhe bazës së llogaritjes përpara përdorimit në Draft VSM.

Indikatorët për klimën dhe mjedisin, përdorimi për kuantifikim

Çfarë mund të kuantifikohet nga Strategjia dhe çfarë duhet të plotësojë VSM-ja

Tema VSM	Indikatorë të Strategjisë	Përdorimi për vlerësim sasior	Mangesite kryesore
GHG dhe energjia	CO ₂ për vehicle-km; EV / hybrid vehicles; karikues publikë; objektivi NECP	Mund të përdoren për skenarët e emetimeve dhe për krahasimin midis tyre	Nevojitet inventari i transportit sipas model/fuel dhe reduktimi total në tCO ₂ e
Modal shift	Pjesa e mallrave perdor transportin hekurudhor dhe detar, target 30%	Mund të llogariten emetimet e shmangura nëse ka ton-km dhe faktorë emitimesh.	Nevojiten volume të mallrave, ton-km dhe skenarë modalë
Cilësia e ajrit	Indirekt, përmes EV, ITS, modal shift dhe transportit publik	Mund të bëhet vlerësim gjysem-sasior dhe më pas modelim nëse ka të dhëna	Mungojnë targeted por ekzistojne limitet për PM ₁₀ , PM _{2.5} , NO ₂ dhe ekspozimin e popullsisë
Toka, ujërat, biodiversiteti	Nuk ka indikatorë të plotë sasiorë në Strategji	VSM duhet të përdorë GIS, projektet, feasibility/ESIA dhe receptorët e ndjeshëm	Mungojnë land take, habitat loss, water crossings, materiale ndërtimi dhe spoil

Për VSM-në, indikatorët e Strategjisë duhet të shoqërohen me baseline, metodologji llogaritjeje, burim të dhënash, pronar institucional dhe frekuencë raportimi.

Indikatorët socialë për vlerësimin sasior

Përdorimi i indikatorëve për aksesueshmërinë, sigurinë, shërbimin dhe qeverisjen

Tema sociale	Indikatorë të Strategjisë	Përdorimi në VSM	Plotësime të nevojshme
Siguria rrugore	Vdekje për 100,000 banorë; target - 50%	Indikator i drejtpërdrejtë për shëndetin publik dhe sigurinë	Të shtohen dëmtimet e rënda, black spots, grupet e cenueshme dhe siguria e këmbësorëve/çiklistëve
Transporti ndërqytetës	% e linjave të ristrukturuara / optimizuara	Mat aksesin në shërbime dhe cilësinë e rrjetit	Nevojiten të dhëna për frekuencën, tarifat, mbulimin rural dhe grupet me akses të kufizuar
Të drejtat e pasagjerëve	Autoritet/strukturë kombëtare, jo → po; platformë ankesash	Mat forcimin institucional dhe transparencën e shërbimit	Nevojiten ankesa, vonesa, anulime, kohë përgjigjeje dhe cilësi shërbimi
Aksesueshmëria PRM	% terminalesh/mjetesh të aksesueshme	Mat përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe aksesin universal	Nevojiten auditime të terminaleve, mjeteve dhe stacioneve, me target të qartë
Qeverisja dhe monitorimi	Sipas indikatorëve, raportim gjashtëmuor dhe vjetor	Bazë për programin e monitorimit të VSM-së	Duhet harmonizim me INSTAT, MIE, NECP, operatorët dhe bashkitë

Strategjia ofron indikatorë të dobishëm të zbatimit, por jo një kuantifikim të plotë të ndikimeve mjedisore, sociale apo klimes.
VSM duhet të plotësojë Strategjinë me indikatorë për GHG, ajër, zhurmë, biodiversitet, ujë, tokë, trashëgimi kulturore, aksesueshmëri dhe përballueshmëri.
Për çdo indikator kryesor nevojitet gjendja ekzistuese, targeti, njësia, metoda e llogaritjes, burimi dhe institucioni përgjegjës.

Alternativat analitike te Strategjisë per qellimet e VSM.

Vlerësimi është strukturuar sipas qasjes së VSM, ku alternativat krahasohen me objektivat mjedisore, sociale dhe klimatike, dhe kategorizohen sipas rëndësisë së ndikimit.

Metoda e vlerësimit, A = ndikim zero ose pozitiv, B = ndikim i pakonsiderueshëm, C = i pranueshëm me masa zbutëse, D = ndikim i konsiderueshëm, X = i papërcaktueshëm.

Alt.	Skenari	Implikimi strategjik	OM1 Klima dhe ajri	OM2 Natyrë, tokë, ujë	OM3 Popullsia, shëndet, siguri	OM4 Qeverisje dhe monitorim	Konkluzioni VSM
A0	Moszbatimi / status quo	Ruhet fragmentimi i sistemit, dominimi rrugor dhe progres i ngadaltë në TEN-T, dekarbonizimin, sigurinë dhe digjitalizimin.	D	D	C/D	C/D	Jo e rekomanduar
A1	Zbatim i orientuar kryesisht në infrastrukturë rrugore	Përshejton korridoret TEN-T dhe përfitimet ekonomike, Përmirëson lidhshmërinë, por mund të rrisë presionin mbi tokën, habitatet, zhurmën, cilësinë e ajrit dhe klimën.	C	C/D	C	C	E pranueshme, por jo e preferuar
A2	Zbatim i integruar, multimodal, i gjelbër dhe digjital	Prioritizon zhvendosjen modale, hekurudhën dhe transportin publik, karburantet alternative, SUMP dhe reziliencën klimatike.	A	B/C	A/B	A	Alternativa e preferuar
A3	Propozim Tjeter						

Implikimi kryesor për VSM, A2 duhet të merret si bazë planifikimi, me kusht që investimet të kalojnë përmes hierarkisë shmangie, zbutje dhe kompensim, climate-proofing, analizë alternativash në nivel projekti dhe monitorim të treguesve mjedisorë.

Përmbledhje e gjetjeve kryesore dhe rekomandime për studimin e VSM

Fokusi i Draft VSM-së duhet të ndajë qartë ndikimet hapësinore të investimeve nga ndikimet jo-infrastrukturore që varen nga planifikimi, sistemet, teknologjia dhe efica.

Gjetjet kryesore të Vleresimit Paraprak

- Shumica e ndërveprimeve janë **Scope-In**, prandaj studimi i VSM-së duhet të fokusohet tek **objektivat me prioritet të lartë**.
- Ndikimet pozitive lidhen kryesisht me uljen e GHG, cilësinë e ajrit, sigurinë, aksesueshmërinë, lëvizshmërinë dhe qeverisjen.
- Ndikimet negative ose të pasigurta lidhen kryesisht me vendndodhjen e investimeve, tokën, habitatet, ujërat, zhurmën dhe efektet kumulative.
- Masat jo-infrastrukturore kanë kryesisht efekte indirekte, por janë vendimtare për performancën mjedisore dhe sociale të Strategjisë.
- Indikatorët e Strategjisë janë të vlefshëm për VSM, por kërkojnë konfirmim të gjendjes, targeteve, njësive, metodës së llogaritjes dhe burimit të të dhënave.
- Për çështje ose ndikime ende të paqarta, VSM-ja do të kryejë vleresime cilesore ose do propozojë të trajtohen më tej në VNM-të e projekteve.

Për diskutim/komente

A reflekton fusha e vlerësimit të VSM-së në mënyrë të mjaftueshme objektivat dhe masat prioritare të Strategjisë?

A ka çështje mjedisore, sociale ose klimatike shtesë që duhet të përfshihen në studim?

A ka të dhëna, studime, harta ose informacione institucionale që rekomandohen për studimin e VSM-së?

A ka komente/sygjerime të tjera lidhur me metodologjinë, fushën e studimit, indikatorët ose alternativat?

Komentet/propozimet gjatë takimit konsultues
paraprak

Në vijim: nëpërmjet komunikimit zyrtar ose email
brenda dates 10 Gusht 2026. tek:
Zana.Joca@infrastruktura.gov.al

Faleminderit